



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.471/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK - Nisma, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet e pasafatshme ankesa Anr.471/2025 e datës 09.02.2025 e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK - Nisma, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.471/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se kandidati për deputet nga AAK-NISMA, Zafir Berisha, ka postuar në profilin e tij në facebook një tekst, ku duke përdorur gjuhë denigruese, akuzuese dhe urrejtëse me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit z. Albin Kurti dhe duke bërë akuza të pabazuara ka shkruar: *"Klithmat dhe piskamat cep në cep të Kosovës nga Albini, nuk kanë të bëjnë me nuhatjen e fii për humbje të pushtetit, Hallin e ka, se po e pretë Dubrava, milionat e vjedhura në KEK, rezervat shtetërore, tenderat një burimoré' etj etj, do të trajtohen nga organet e drejtësis, do a po nuk do ai"*. *"Sulmet kundër prokurorisë të shtetit gjatë gjithë fushatës, dhe premtimi për themelimin e organeve paralele në drejtësi në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet në fuqi është përpjekja e fundit që Albini po mundohet për me i ik Dubravës"*. Si provë ka bashkangjitur, Fotografi dhe linku tekstit të shpërndarë në Facebook: <https://www.facebook.com/share/p/18nfPEmnVy/>

Te njëjtit ne ankesë theksojnë se postimi i tillë i z. Berisha, i cili postim ende vazhdon të jetë aktiv në facebook, LVV kishte paraqitur ankesë në PZAP më 5 shkurt 2025/ mirëpo për shkak të një gabimi teknik sa i përket listimit të subjektit, PZAP me vendimin numër Anr 387/ 2025/ kishte refuzuar ankesën e tillë. Postimi i tillë ende vazhdon të jetë aktiv në llogarinë personale të Zafir Berisha.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur, subjekti politik AAK-Nisma ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe kanë theksuar se ankesa është e

pasafatshme, ngase e njëjta duhet të paraqitet 48 orë nga momenti që ndodh shkelja, ndërsa, të njëjtit kanë bashkangjitur një provë ku është më e vjetër se 96 orë.

Paneli pas vlerësimit paraprak të ankesës, vëren se ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 09.02.2025, ku ka pretenduar se subjekti politik AAK-Nisma gjegjësisht kandidati për deputet nga ky subjekt politik Zafir Berisha është përgjegjës për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 09.02.2025, në ora 09.10, kurse nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-i postimi për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datën 04.02.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik, LVV, kundër AAK-Nisma, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, neni 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe neni 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.471/2025 më datë 11.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.